



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e vendimit: 9 janar 2017

Nr. i lëndës 2014-10

J.Q.

kundër

EULEX-it

Pas kërkesës nga ankuesi që identiteti i tij të mbahet konfidencial, për shkak të kërcënimeve të pretenduara ndaj tij dhe familjes së tij, në përputhje me *rregullin 44 Përmirësimi i gabimeve dhe rishikimi editorial*, dhe *rregulli 45 Shmangiet në raste individuale*, i rregullores së punës, më 11 qershor 2021, Paneli vendosi të modifikojë titullin dhe tekstin e vendimit mbi papranueshmëri të miratuar më 9 janar 2017 në mënyrë që të ruhet konfidencialiteti i ankuesit.



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e vendimit: 9 janar 2017

Nr. i lëndës 2014-10

J.Q.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, në takimin e mbajtur me 9 janar 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga:
Z. John RYAN, zyrtar ligjor i lartë
Znj. Noora AARNIO, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregulloren e punës së Panelit, të ndryshuar me 15 janar 2013.

Pas shqyrtimit, vendosi si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa ishte regjistruar me datën 5 mars 2014.
2. Ankesa i ishte komunikuar shefit të Misionit (ShM) me 25 qershor 2014.
3. Shefi i Misionit i ka dërguar vërejtjet me 10 nëntor 2014. Ato iu ishin komunikuar ankuesit me 17 nëntor 2014.

4. Ankuesi ka paraqitur vërejtje të mëtejme me 18 nëntor 2014.
5. Me 8 tetor 2015, Paneli ka kërkuar sqarime të caktuara nga ankuesi. Përgjigjet ndaj kësaj kërkesë ishin marrë nga Paneli me 13 tetor 2015.
6. Me 15 tetor 2015, Paneli ka kërkuar vërejtje të mëtejme nga ShM-ja në lidhje me parashtrimet e ankuesit. Vërejtjet e ShM-së si përgjigje ishin marrë me 16 nëntor 2015. Ato vërejtje iu ishin komunikuar ankuesit me 24 nëntor 2015.

II. FAKTET E LËNDËS

7. Faktet e lëndës siç janë paraqitur nga ankuesi mund të përmbliidhen si në vijon: Tema e kësaj çështjeje ka të bëjë me vrasjen e vëllait të ankuesit diku në vitin 1999. Pas kryerjes së atij krimi, ankuesi ka kërkuar në mënyrë efektive hetimin e çështjes dhe identifikimin e atyre që kishin qenë prapa vrasjes së të afërmit të tij. Në atë kontekst, ai u takua me disa persona që mendohej se ishin të ndërlidhur me atë krim dhe informatat e mbledhura i dorëzoi tek Policia e Kosovës si dhe tek EULEX-i.
8. Që nga tetori i vitit 2011, ankuesi i ishte nënshtruar kërcënimeve të ndryshme dhe akteve të dhunës që duket se ndërlidheshin me përpjekjet e tij për hetimin e rastit. Ai i ka raportuar rastet tek Policia e Kosovës dhe tek EULEX-i dhe ishte marrë në pyetje zyrtarisht nga një prokuror i EULEX-it në lidhje me këtë çështje.
9. Me 19 nëntor 2012, ankuesi ishte intervistuar në lidhje me rastin nga një prokuror i EULEX-it.
10. Në një vendim të datës 10 dhjetor 2013, Prokuroria Themelore e Pejës ka konstatuar se Policia e vendit kishte ndërmarrë disa hapa hetimorë në lidhje me çështjen, përfshirë intervistimin e disa personave (të pasaktësuar) dhe gjetjen e varrit të vëllait të ankuesit (P.S.). Më vonë ishte përcaktuar se viktima ishte vërtetuar të kishte vdekur në fund të qershorit 1999.
11. Me 27 dhjetor 2012, bazuar në një kërkesë për ndihmë juridike ndërkombëtare, i biri i të ndjerit, ishte intervistuar nga një gjyqtar i procedurës paraprake në Mal të Zi. I biri i tha se në një datë të pasaktësuar në vitin 1999, babai i tij ishte marrë nga "H." dhe tre persona të tjerë. Ai asnjëherë nuk e kishte parë më babanë e tij.
12. Me 28 dhjetor 2012, një prokuror i EULEX-it ka marrë vendim për fillimin e hetimeve rreth rastit. Vendimi i dhënë saktëson se *"Prokuroria dhe Policia kanë intervistuar rreth 16 dëshmitarë. Megjithatë, ata nuk kanë dhënë informata shumë të rëndësishme rreth kryerësit të veprës penale. Shumica e dëshmitarëve kanë thënë se ata nuk kishin qenë në Kosovë gjatë kohës kur [P.S.] ishte vrasur dhe/apo kanë thënë se ata vetëm kishin dëgjuar fjalë rreth vrasjes së*

[P.S.]. Një dëshmitar kishte thënë se e kishte parë kur [P.S.] ishte marrë prej disa meshkujve, gjoja se me uniforma të UÇK-së, por dëshmitari kishte thënë se ai nuk i kishte njohur ata." "Prokuroria dhe Policia" po ashtu i kishin intervistuar të dyshuarit H.D., A.G., B.K., dhe R.Q. Të gjithë kishin mohuar çfarëdo lloj përfshirje në vrasjen e [P.S.]. I dyshuari N.G. nuk ishte intervistuar, meqë ai nuk jeton në Kosovë. Përveç kësaj, në vendim thuhet se policia dhe prokuroria kishin zbatuar një sërë masash të fshehta, përfshirë përgjimin.

13. Ankuesi pohon se e kishte informuar prokurorin e EULEX-it dhe Policinë e Kosovës në një datë të pasaktësuar në maj të vitit 2013 se do të takohej me personat B.K, Q.K. dhe N.I. Gjatë takimit me ata persona, ankuesi gjoja se ishte kërcënuar "*që ai duhej t'ia falte gjakun lagjes*" në mënyrë që të ndalej vazhdimi i hakmarrjeve dhe se ai asnjëherë nuk do të mund "*të jetonte në Pejë nëse ndokush nga lagja do të hynte në burg*". Më tej, atij gjoja se i ishte thënë se nuk kishte nevojë të dinte se kush e kishte kryer vrasjen. Ankuesi parashtron se pavarësisht se i kishte informuar prokurorët e EULEX-it dhe policinë, asnjë masë e fshehtë nuk ishte ndërmarrë në lidhje me atë takim që do të kishte ndriçuar vrasjen e vëllait të tij, meqë të pranishmit në takim gjoja se e dinin identitetin e vrasësit të vëllait të ankuesit.
14. Në vazhdën e hetimeve, trupi i [P.S.] ishte gjetur dhe zhvarrosur, dhe me kërkesë të prokurorit të EULEX-it ishte marrë një mostër e ADN-së dhe ka konfirmuar se mbetjet mortore ishin të [P.S.]. Më tej, nga autopsia u konfirmua se vdekja ishte shkaktuar nga të shtëna me armë zjarri në gjoks.
15. Bazuar në provat e mbledhura, prokurori i EULEX-it ka vendosur se nuk kishte prova të mjaftueshme për ta mbështetur akuzën ndaj të dyshuarve. Prokurori i EULEX-it mori qëndrimin se nga rrethanat nuk kishte mundësi të arsyeshme që të gjendeshin dëshmi shtesë për ndriçimin e rastit. Andaj, prokurori i EULEX-it vendosi t'i pushojë hetimet.

III. ANKESA

16. Thelbi i ankesës mund të përmbliidhet si vijon:
 - i. Në një datë të pacaktuar në vitin 1999 vëllai i ankuesit ishte vrarë në rrethana që në përgjithësi vazhdojnë të mbeten të panjohura. Si rezultat i hetimeve, trupi i viktimës ishte gjetur dhe ishte përcaktuar se ai kishte vdekur si pasojë e të shtënave me armë zjarri në gjoks. Ankuesi pretendon se hetimet rreth vrasjes së vëllait të tij nuk kishin qenë të mjaftueshme. Ai po ashtu parashtron se vendimi i dhënë nga Prokuroria Themelore në Pejë për pushimin e hetimeve kishte qenë shkelje e të drejtave të tij.
 - ii. Ankuesi i ishte nënshtruar nga një varg kërcënimesh që vinin prej individëve, të cilët ai i ndërlidhë me vrasjen e vëllait të tij.

Duket se ankesa e konsideron EULEX-in përgjegjës për mos veprim të mjaftueshëm për t'i ndaluar ato kërcënime apo për t'i hetuar ato.

- iii. Ai po ashtu ankohet se një pronë e caktuar ishte përvetësuar paligjshëm nga personat e ndërlidhur me vrasjen e vëllait të tij.

Secili aspekt i ankesës do të trajtohet njëri pas tjetrit në vijim.

IV. LIGJI

Parashtrimet e palëve

17. Ankesa nuk i drejtohet në mënyrë specifike ndonjë të drejte të veçantë themelore që ankuesi pohon të jetë shkelur e as nuk identifikon ndonjë dispozitë të të drejtave të njeriut në të cilën kërkon të mbështet. Megjithatë, në bazë të natyrës së ankesës së tij, duket se këtu nenet 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mund të jenë relevante. Përveç kësaj, nga parashtrimet e ankuesit mund të nënkuptohet edhe referenca në nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.
18. Qëndrimi i shefit të Misionit në lidhje me këto po ashtu është paraqitur në vazhdim si i rëndësishëm për zgjidhjen e këtij rasti.

Vlerësimi i Panelit

Konsiderimet e përgjithshme lidhur me pranueshmërinë e ankesave

19. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të përdor instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
20. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
21. Sipas Rregullit 25, paragrafi 1, Paneli mund t'i shqyrtojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it Kosovë gjatë zbatimit të mandatit të tij ekzekutiv.
22. Më tej, sipas rregullës 25, paragrafi 3, i Rregullores së Punës së Panelit, ankuesi duhet të paraqesë ankesë brenda gjashtë muajve

nga vepra, vendimi apo veprimi që pretendohet se përbën ose përfshin ndonjë shkelje të të drejtave të tij/saj. (shih p.sh. *Gashi kundër EULEX*, nr. 2013-22, 7 prill 2014, § 10; *Thaqi kundër EULEX-it*, nr. 2010-02, 14 shtator 2011, § 51; *Sadiku-Syla kundër EULEX*, 2014-34, 29 shtator 2014, §§ 40 e tutje).

Mjaftueshmëria e hetimeve të rrethanave të vrasjes dhe pushimi i hetimeve

23. Kjo pjesë e ankesës është duke u shqyrtuar në kuptim të neneve 2, 8 dhe 13 të Konventës dhe në veçanti të detyrimeve procedurale nga neni 2.
24. Vëllai i ankuesit, [P.S.], ishte vrarë diku në vitin 1999 në rrethana që nuk janë ndriçuar plotësisht. Ankuesi pretendon se viktima ishte vrarë “vetëm pse kishte qenë i besimit katolik”.
25. Ankuesi i ka dhënë emrat e personave për të cilët ai dyshon se kanë qenë të përfshirë në vrasjen, emrat e dëshmitarëve potencialë dhe informata të tjera rreth rastit. Këto informata i ishin dhënë autoriteteve vendore si dhe prokurorëve të EULEX-it. Bazuar në këtë, duket se ankuesi pohon se, pasi që është informuar rreth identitetit të të dyshuarve të mundshëm, EULEX-i nuk ka bërë mjaftë për të hetuar çështjen dhe për t'i sjellë ata para drejtësisë. Me 10 tetor 2012, ankuesi ka dërguar “letër nga ankuesi” tek prokurorët e EULEX-it lidhur me ato që ai i quajti dështime hetimore të Misionit. Si përgjigje ndaj kësaj, ai ishte intervistuar me 19 nëntor 2012 nga një prokuror i EULEX-it përgjegjës për rastin.
26. ShM-ja shpjegon një sërë hapash hetimor pasues që ishin ndërmarrë nga EULEX-i si dhe nga policia vendore:
 - Siç u theksua, me 19 nëntor 2012, ankuesi ishte intervistuar nga një prokuror i EULEX-it në lidhje me rastin.
 - Disa persona të tjerë ishin intervistuar nga Policia në lidhje me rastin.
 - Policia e Kosovës ka gjetur varrin e [P.S.] dhe e ka përcaktuar shkaku e vdekjes së tij.
 - Me 25 janar 2012, Policia e Kosovës ka intervistuar një person në lidhje me zbulimin e trupit të viktimës.
 - Me 26 janar 2012, një dëshmitar tjetër ishte intervistuar nga Policia në lidhje me çështjen.
 - Me 27 dhjetor 2012, në bazë të një kërkesë për ndihmë juridike ndërkombëtare, i biri i viktimës ishte intervistuar nga një gjyqtar në Mal të Zi.
 - Me 28 dhjetor 2012, një prokuror nga EULEX-i ka nxjerrë vendim për fillimin e hetimeve ndaj disa të dyshuarve.
 - Pas kësaj, prokurorët e EULEX-it lëshuan 12 autorizime për Policinë e Kosovës në bazë të të cilave në vitin 2013 u paraqitën 12 raporte policore.
 - Në vitin 2013, prokuroria e EULEX-it ka parashtuar dy kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare (Suedisë dhe Malit të Zi).

- Prokuroria e EULEX-it po ashtu ka parashtruar kërkesë dhe me 4 shkurt 2013 gjykata ka dhënë urdhër për autorizimin e zhvarrosjes së trupit të viktimës me qëllim të kryerjes së autopsisë. Raporti i autopsisë u përgatit dhe u përcaktua se viktima kishte vdekur nga të shtëna me armë zjarri në gjoks.
 - Duke filluar në janar të vitit 2013, policia dhe prokuroria po ashtu kanë zbatuar 11 masa të fshehta, përfshirë përgjime telefonike, vëzhgime dhe incizime të fshehta me qëllim të marrjes së informatave përkatëse rreth rastit. Prej të dhënave kuptohet se EULEX-i ka ndihmuar në së paku disa prej atyre masave.
 - Me 14 mars 2013, Policia e Kosovës ka ofruar shpërblim për informata rreth rastit.
 - Me 30 prill 2013, ankuesi ishte intervistuar prapë.
 - Me 18 qershor 2013, prokuroria e EULEX-it ka kontaktuar autoritetet e Malit të Zi për të marrë një deklaratë të një dëshmitari të caktuar dhe për të pasur qasje në një dosje të caktuar. Kjo kërkesë për ndihmë ishte miratuar dhe informatat përkatëse ishin siguruar.
 - Me 27 qershor 2013, një prokuror i EULEX-it ka autorizuar paraburgosjen e dy të dyshuarve. Në qelitë e tyre ishin vendosur pajisje të përgjimit. Kjo masë e cila nuk dha rezultat ishte ndërprerë një ditë më pas.
 - Në vitin 2013, EULEX-i po ashtu ka intervistuar dy dëshmitarë dhe dy të dyshuar, ndërsa Policia e Kosovës ka intervistuar gjashtë dëshmitarë dhe katër të dyshuar.
27. Me 10 dhjetor 2013, pas shqyrtimit të dosjes, rasti zyrtarisht kishte pushuar. ShM-ja ka bërë të ditur se ai vendim ishte marrë për shkak të pamjaftueshmërisë së dëshmive lidhur me rrethanat e përgjithshme të vrasjes së viktimës apo dëshmive ndaj ndonjë të dyshuari. ShM-ja po ashtu thekson se prokurorët e EULEX-it ishin përfshinë në këtë rast vetëm pas 12 viteve pas vrasjes në fjalë. ShM-ja konkludon se Misioni i ka ndërmarrë të gjitha hapat hetimorë përkatës në lidhje me këtë rast dhe nuk mund të thuhet se i ka shkelur të drejtat e ankuesit.
28. Paneli vëren shkallën e lartë të bashkërendimit midis EULEX-it dhe autoriteteve vendore në lidhje me këtë rast. Përderisa Misioni natyrisht se nuk mund t'i delegojë tek të tjerët obligimet e veta për respektimin e të drejtave të njeriut, sigurisht se është operacionalisht e mundur që Misioni t'i bashkërendojë përpjekjet e veta hetimore me autoritetet vendore në vend se të veprojë i vetëm apo t'i lë autoritetet vendore t'i kryejnë vetë të gjitha ato veprimet. Prandaj Paneli nuk mund ta kritikojë vendimin e Misionit për ta bartur së bashku barrën hetimore në lidhje me këtë rast me autoritetet vendore.
29. Gjatë vlerësimit të veprimeve të Misionit lidhur me këtë çështje, Paneli ka marrë parasysh të gjitha të dhënat hetimore të këtij rasti me qëllim të përcaktimit nëse veprimet e Misionit nuk i kanë përmbushur atë që pritet nga Misioni për nga pikëpamja e ligjit të të drejtave të njeriut.
30. Si çështje paraprake, Paneli do të theksoj se hetimi i këtij rasti do të kishte qenë jashtëzakonisht i ndërlikuar në rrethanat që kanë

ekzistuar. EULEX-i ishte përfshirë në çështjen vetëm pothuajse dymbëdhjetë vite pas krimit. Dëshmitë e mjekësisë ligjore atëherë veç se nuk ekzistonin. Dëshmitarët okularë të vrasjes nuk ishin në dispozicion. Të dyshuarit nuk mund të implikoheshin qartazi në vrasjen.

31. Paneli gjithashtu vëren se Misioni (në bashkëpunim me autoritetet e vendit) ka ndërmarrë një numër të madh hapash hetimorë për këtë rast dhe ka investuar kohë si dhe burime të konsiderueshme në përpjekjet për zgjidhjen e rastit. Paneli ndjen keqardhje për dhimbjen dhe zhgënjimin e ankuesit si rezultat i moszgjidhjes së rastit dhe mos sjelljes para drejtësisë të vrasësve. Sidoqoftë Paneli nuk mund të konstatoj se kjo është si pasojë e ndonjë akti apo lëshimi të fajshëm që i atribuohet Misionit. Ndryshe Paneli është i bindur se veprimet e Misionit në lidhje me këtë rast kanë qenë operacionalisht në përputhje me detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut.
32. Si përfundim, qëndrimi i Panelit është se Misioni nuk i ka shkelur të drejtat e ankuesit në kontekstin e përfshirjes së Misionit në hetimin e rastit në fjalë.

Kërcënimet dhe mbrojtja e ankuesit

33. Kjo pjesë e ankesës shqyrtohet në pajtim me nenin 3 të Konventës.
34. Ankuesi u referohet një sërë incidentesh ku thotë se është kërcënuar prej individëve të caktuar që mendohet të kenë pasur lidhje me vrasjen e vëllait të tij.
35. Në veçanti, ankuesi i referohet një incidenti të datës 15 tetor 2011, ku ishte kërcënuar prej një individi, të cilin ai e ndërlidhë me vrasjen e vëllait të tij. EULEX-i ishte njoftuar për këtë rast me 10 tetor 2012. Së pari, ky incident bie jashtë afatit kohor prej gjashtë muajve për paraqitjen e ankesës tek Paneli, andaj është i papranueshëm vetëm për atë arsye sipas Rregullës 29(1)(c), në lidhje me Rregullën 25(3), të Rregullores së punës së Panelit. Sidoqoftë, në bazë të të dhënave nuk ka ndonjë tregues se EULEX-i ka marrë ndonjëherë përgjegjësinë për ta hetuar atë incident. Përkundrazi, ShM-ja vëren se incidenti ishte raportuar në stacionin e policisë në Prishtinë dhe rasti pastaj ishte përcjellë tek policia e Pejës për veprime të mëtejme. ShM-ja po ashtu ka bërë të ditur se Prokuroria e EULEX-it e kishte kontaktuar Prokurorinë Themelore të Pejës dhe ishte informuar se çështja ishte ende nën hetime. ShM-ja pohon se ky rast në të vërtetë asnjëherë nuk ka qenë pjesë e hetimeve të EULEX-it por se gjatë gjithë kohës ka qenë nën kompetencën e policisë vendore. Paneli nuk ka arsye ta kontestoj vlefshmërinë e këtij pohimi.
36. Ankuesi gjithashtu i referohet një takimi të mbajtur në maj të vitit 2013, ku ishte nënshtruar një kërcënim të mëtejshëm nga palë të treta që besohet se kishin lidhje me vrasjen e vëllait të tij. Edhe një herë, këto

incidente bien jashtë afatit kohor prej gjashtë muajve, të caktuar për paraqitjen e ankesës tek Paneli, andaj vetëm mbi bazë të kësaj janë të papranueshme. Për më tepër, përderisa ankuesi sugjeron se prokurorët e EULEX-it (dhe Policia e Kosovës) ishin të informuar për këtë rast, ai nuk mund të vërtetojë se EULEX-i kishte marrë përgjegjësinë për hetimin e tij. ShM-ja më tutje thekson se ky incident ishte raportuar tek Prokuroria Themelore e Kosovës nga ana e Policisë së Kosovës dhe beson se ishte konsideruar si “vazhdimësi e ‘rastit të kërcënimit’ që veçse kishte qenë i hapur” prej autoriteteve vendore.

37. Po ashtu iu është referuar edhe një incidenti tjetër të kërcënimeve që e ka përmendur ShM-ja, dhe që thuhet se kishte ndodhur në një datë të pacaktuar në Greqi. Pas njoftimit lidhur me këtë incident, një prokuror i EULEX-it e kishte këshilluar ankuesin që ta raportonte çështjen tek policia e Greqisë – rreth së cilës ai nuk e kishte bërë. Ky incident nuk është vërtetuar mjaftueshëm në mënyrë që Paneli të del me të gjetura përfundimtare rreth tij. Andaj, nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të sugjeruar se ky incident, nëse ka ndodhur, do të binte nën përgjegjësinë e EULEX-it.
38. Në fund, Paneli vëren parashtrimet e ShM-së se Prokuroria e EULEX-it nuk e ka konsideruar veten kompetente për të shqyrtuar “rastet e kërcënimeve” sipas Ligjit nr. 03/L-053, përveç nëse ato raste ishin të motivuara nga urrejtja sipas nenit 11. Për arsye të asaj që u cek më lartë, Paneli nuk ka nevojë të vendosë nëse kërcënimet në rastin aktual do të binin brenda fushëveprimit të përjashtimit “të motivuara nga urrejtja”. Megjithatë, Paneli vëren pretendimin e ankuesit se viktimat mund të ishin shënjestruar për shkak se ishin të besimit katolik. Paneli po ashtu vëren se kompetenca e EULEX-it për këtë rast do të mund të arsyetohej nga lidhja që ekziston mes incidentit të vrasjes së paligjshme (për të cilin rast Prokuroria e EULEX-it do të mund të ushtronte kompetencën) dhe kërcënimeve të ndërlidhura me të. Megjithatë, duke pasur parasysh se çështja vazhdon të shqyrtohet nga autoritetet vendore pa ndonjë sugjerim se ata janë duke e bërë në mënyrë joefektive, Paneli nuk ka nevojë të përcaktojë nëse Misioni do të duhej të kishte ushtruar kompetencën e tij “të jashtëzakonshme” për atë rast.
39. Pavarësisht asaj që u cek më lartë, nga të dhënat e këtij rasti është evidente se vrasja e vëllait të tij ka krijuar mjedis potencialisht të pasigurt për ankuesin. Paneli është në veçanti i shqetësuar nga mungesa e informatave të qarta në lidhje me vlerësimin e rrezikut të kryer për këtë çështje dhe nga fakti se ankuesit asnjëherë nuk iu ishte ofruar asnjë masë mbrojtëse pavarësisht se kishte ofruar informata të ndjeshme rreth rastit.
40. Në bazë të faktit se hetimet për ato kërcënime ende janë duke vazhduar pranë autoriteteve vendore, Paneli nuk ka nevojë të vendosë nëse rasti tani duhet të merret përsipër nga Misioni në kuadër të ushtrimit të kompetencave “të jashtëzakonshme” sipas nenit

7(A) të Ligjit të ndryshuar për Juridiksionin. Megjithatë, me qëllim të garantimit të mbrojtjes efektive të të drejtave të ankuesit që është obligim i përgjithshëm i Misionit, Paneli e fton ShM-në të shikojë mundësinë që të kërkoj nga prokurorët e EULEX-it të komunikojnë me homologët e tyre vendor me qëllim të vërtetimit nëse hetimet e tyre në lidhje me kërcënimet janë ende në vazhdim e sipër, dhe nëse duhet të ndërmerren masa të caktuara për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e ankuesit. Kjo do t'i mundësonte Misionit të siguronte se të drejtat e ankuesit janë duke u mbrojtur në mënyrë efektive dhe do ta vinte Misionin në një pozitë që të përcaktohet nëse do ta merr përsipër përgjegjësinë e këtij hetimi.

41. Paneli po ashtu vëren me miratim pohimin e ShM-së se ai do t'i ofrojë shefit të Divizionit për Fuqizim informata përkatëse për rastin.

42. Në bazë të asaj që u tha më lartë, Paneli konstaton se kjo pjesë e ankesës është e papranueshme.

Çështjet e pronës

43. Kjo pjesë e ankesës shqyrtohet në bazë të neneve 8 dhe 13 të Konventës si dhe nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës.

44. Ankuesi po ashtu pohon se prona që i ka takuar vëllait të tij të ndjerë ishte blerë në mënyrë të paligjshme me 12 korrik 2002 në bazë të dokumenteve të rreme apo të falsifikuara. Ankuesi nuk e bënë të qartë se përse ai sugjeron që Misioni mund të jetë përgjegjës në lidhje me këtë çështje.

45. Së pari, Paneli nuk është bindur se ankuesi ka qenë “viktimë” e akteve të përshkruara më lartë që do të ishin të nevojshme për t'i dhënë bazë për ngritjen e kësaj çështje para Panelit (lidhur me statusin e “viktimës” së ankuesit, shih rastin Mustafa-Sadiku kundër EULEX-it, 2014-41, 15 qershor 2015, par 14; I kundër EULEX, 2013-01, 27 nëntor 2013, paragrafët 17-22; Emërllahu kundër EULEX-it, 2012-15, 8 prill 2013, paragrafët 10-13). Ajo pronë nuk ka qenë e tij, si dhe ligji për të drejtat e njeriut nuk parasheh mundësinë e përgjithshme që të afërmit e personave të vdekur të paraqesin pretendime lidhur me të drejtat pronësore në emër të të vdekurve. Në këto rrethana, është e paqartë nëse ankuesi është kompetent për ta parashtruar këtë çështje në Panel në mungesë të treguesve të qartë se ai është viktimë e veprimit të kontestuar.

46. Së dyti, dhe prandaj incidenti të cilit i referohet ankuesi ka ndodhur më shumë se 12 vite para paraqitjes së ankesës, andaj ankesa nuk është paraqitur nuk e plotëson afatin kohor gjashtë muajsh që përcaktohet me rregullën 29(1)(c), në lidhje me rregullën 25(3) të Rregullores së Punës së Panelit (“Ankesat duhet të paraqiten në Panel brenda gjashtë muajve nga data kur ka ndodhur shkelja e

pretenduar.”). Andaj, sipas rregullave të cekura, ankesa është e papranueshme.

47. Së treti, edhe nëse ankuesi do të kishte bazë në lidhje me këto çështje, Paneli vëren se, me kërkesë të një prokurori të EULEX-it, autoritetet e Kosovës e kanë shqyrtuar këtë çështje dhe kanë përcaktuar se blerja e pronës kishte qenë e ligjshme. Në bazë të informatave që Paneli i posedon, pretendimi i ankuesit për bartje të paligjshme të pronës nuk është vërtetuar dhe pretendimi i ndërlidhur i shkeljes së të drejtave është i pabazuar.
48. Në fund, sa i përket përfshirjes së EULEX-it në këtë aspekt të caktuar të rastit, ankuesi nuk i është drejtuar asnjë veprimi apo lëshimi të fajshëm që i atribuohet Misionit e që do të mund të konsiderohej të ketë rezultuar në shkeljen e të drejtave të tij.
49. Ankuesi po ashtu i referohet dëmit që pretendohet t'i jetë shkaktuar pronës së tij dhe “vijës pronësore” për të cilën ai thotë se e kishte raportuar në policinë vendore. Në lidhje me këtë incident, nuk ka asnjë tregues që kjo të ketë ndodhur gjatë periudhës gjashtëmujore para paraqitjes ankesës. Prej parashtresave të ShM-së, kuptohet se ai incident mund të ketë ndodhur me 19 gusht 2013, pra që nënkupton se bie jashtë afatit gjashtëmujor të përcaktuar me rregullën 29(1)(c) në lidhje me rregullën 25(3) të Rregullave të Panelit.
50. Edhe po që se ai incident do të kishte ndodhur brenda periudhës përkatëse gjashtëmujore, nuk ka asnjë tregues se EULEX-i kishte ndonjë rol në hetimin e këtij incidenti apo që EULEX-i të jetë fajtor në lidhje me atë. ShM-ja pranon se Misioni ishte njoftuar rreth incidentit, por thekson se faktet në lidhje me atë incident ishin raportuar në mënyrë “tejet të paqartë”. Duket se qëndrimi brenda Misionit është marrë se ky rast ka hyrë, sikur edhe incidentet e tjera të ndërlidhura me këtë rast, në kompetencën e autoriteteve vendore. Ankuesi nuk e ka vërtetuar se Misioni ka vepruar në mënyrë arbitrare apo të paarsyeshme kur ka dalë me atë qëndrim.
51. Për arsyet e dhëna si më lartë, Paneli e konsideron këtë pjesë të ankesës si të papranueshme.

Çështjet lidhur me një palë të tretë

52. Ankuesi po ashtu pretendon se të drejtat e birit të të ndjerit janë shkelur (në veçanti e drejta e tij për të mos iu nënshtruar torturës apo formave të tjera të keqtrajtimeve). Ankuesi duket se e bazon atë pretendim në atë se informatat që ai person ia kishte dhënë autoriteteve nuk ishin hetuar në mënyrë të duhur.
53. Paneli e ka shqyrtuar këtë pjesë të ankesës në aspektin e neneve 3 dhe 13 të Konventës.

54. Paneli nuk është i bindur se ankuesi mund të konsiderohet “viktimë” e akteve që e prekin birin e të ndjerit. Ai po ashtu nuk ka ofruar tek Paneli asnjë dokument që do ta autorizonte atë për të vepruar në emër të dikujt tjetër për këtë çështje. Andaj ai nuk ka bazë për ta ngritur këtë çështje në emër të të afërmit të tij.

55. Prandaj kjo pjesë e ankesës është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se, në bazë të Rregullave 25(3) dhe 29(1)(c)-(e) ankesa është e papranueshme.

Pavarësisht këtij konstatimi, në kuadër të ushtrimit të autoritetit për diskrecion, Paneli

E fton ShM-në të shqyrtojë mundësinë që të kërkoj nga prokurorët e EULEX-it të komunikojnë me homologët e tyre vendorë në mënyrë që të përcaktohet nëse hetimet e tyre ndaj këtyre kërcënimeve janë ende në vazhdim e sipër dhe nëse duhet të ndërmerren masa të përshtatshme për ta garantuar sigurinë dhe mirëqenien e ankuesit.

Për Panelin,

John RYAN
Zyrtar ligjor i lartë

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese